

Relacion Teknik

Objekti: "Investime ne rjetin e ndricimit me ndriçues ekonomik"

Nje veshtrim mbi ndricimin ne fshatrat e Bashkise Himare:

- Pasoje e investimeve te pakta nga ana e Bashkise Himare gjendja e ndricimit rrugor e fshatrave ne jurifksionin e saj ka ardh nga viti ne vit te perkeqesohet, duke evidentuar shume defekte dhe realisht nje ndricim jo te mire; nuk ka investime prej bashkise per mjaft vite, pasoje e paaftesise financiare te saj;
- Ne kete gjendje ka ndikuar edhe financimi zero nga buxheti shtetit, jo me per linjat e fshatrave por dhe te furnizimit qendror me energji, por fale investimeve te fundit te kesaj qeverie, kjo ka ndryshuar pozitivisht duke rritur treguesit e energjiise elektrike ne zone; ndersa per ndricimin e rjetit te fshatrave te kesaj bashkie ende nuk ka asnje lloj investimi;
- Fale nje perkujdesje te perviteshme te ekipit elektrikist te Bashkise Himare, me masat e vazhdueshme te mare, eshte realizuar nje mirembajtje e perhershme e ketyre linjave, por eshte e pamjaftueshme per te siguruar nje gjendje te mire te ndricimit te fshatrave te bregdetit dhe te te gjitha fshatrave te Bashkise Himare;
- Duke bere nje vizite ne te gjitha qendrat e fshatrave, ekipi elektrikist i Bashkise Himare, evidentoi situaten e ndricimit, evidentoi ne vend gjendjen e tij dhe parashikuan masa per permiresimin e saj, duke bere prezent te gjitha nevojat qe sistemi ka aktualisht;
- Ne kuader te masave per permiresimin e sistemit te ndricimit te disa fshatrave te Himares, mbi bazen e planit te investimeve te miratuar te vitit 2018, organizohet edhe ky investim, me synimin e ndryshimit sadopak te gjendjes se ketij sistemi;

Masat per permiresimin e ndricimit te fshatrave te Bashkise Himare:

- Hartimi i nje projekti elektrik per permiresimin e sistemit te ndricimit, duke e kompletuar me te gjitha elementet e nevojshem te tij, projekti zbatimit, detajet

elektrike, ky relacion sqaruas i procesit, specifikimet teknike te zbatimit te punimeve elektrike per gjendjen dhe dokumenta te tjera shoqeruese te projektit;

➤ Hartimi i preventivit te punimeve elektrike te mbeshtetura ne manualin e çmimeve te vitit 2015, sipas VKM Nr.629, date 15.07.2015, qe aktualisht eshte ne fuqi; analizat teknike qe nuk jane ne VKM Nr.629 jane hartuar sipas librit Nr.6 "Montimi i linjave dhe te nenstacioneve" dhe te atij te "Normave komunale", sipas udhezimit Nr.2, date 08.05.2003 ne mbeshtetje te Ligjit Nr.8402, date 10.09.1998;

➤ Ne kete preventiv punimesh elektrike jane perfshire fshatrat: Gjilek, Dhermi, Vuno, Himare Fshat, Himare Central Fushe Sporti, Himare Stefanel, Qeparo Fush, Qeparo Kudhes, Rruga kombetare Himare Sarande, Borsh, Piqeras, Sasaj, Lukove, Shen Vasil dhe Nivice. Theksojme se edhe ne keto qendra fshati nuk jane perfshire te gjithë nevojat e evidentuara, por ne pjese e tyre, qe alternon ne total ne 50% te sasise se domosdoshme per kompletimin e tyre.

➤ Per te siguruar nje permiresim te mjaftueshem te sistemit te ndricimit ne kuader te ketij fondi e projekti jane perfshire: furnizim e montim ndricues smart VP CL1 CR MS 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V, furnizim e montim krah dy degesh per shtylla metalike per ndricim, furnizim e montim kuader komandimi komplet me santeri, fotoelement dhe "Rele Muzgu", furnizim e montim kablo "ABC" Al S=50 mm², furnizim e montim kabllo Ø2.5 mm per lidhje pergjate shtylles dhe furnizim e montim kabllo 2x1.5 mm.

Grupi projektues:
K&F Consulting shpk
Ing.Elektrik Maria Vasili